Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**11.12.2023**	**18.12.2023**	**2023/0976**
Eksperti Teknik **Taulant Ahmeti**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **12.12.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.12.2023, OE "ARHIKO .ING SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0976, kundër vlerësimit të projektit ideor, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Punimi i projektit kryesor dhe mbikeqyrjes profesionale per ndertimin e objektit te Gjykates Themelore ne Peje" me nr. të prokurimit: "328-23-6142-2-2-3", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Keshilli Gjyqesor i Kosoves.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, vlera e parashikuar e kontratës: 80,000 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 15/06/2023

Hapja e ofertave: 01/08/2023

Vendimi i AK-së: 20/11/2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0976 i dt:04.12.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP:Qëllimi -Neni 7 i LPP:Barazia në trajtim jo diskriminimi; Neni 52 i LPP:Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës; Neni 56 i LPP:Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave; Neni 59 i LPP:Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve; Neni 60 i LPP:Kriteret për Dhënien e Kontratës -Neni 65 i LPP:Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve; Neni 80 i LPP:Përbërja dhe vendimet e juris.; Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik, nenin 17.12; Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik- 46(46.7)-Procedura Tenderuese Një-zarf dhe Dy-zarfa; Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik- 55.18 Kriteret e dhënies për projektimin Ideor; Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik- 55.26-Hapja dhe vleresimi i projekteve; Udhëzues nr.001/2023 për prokurimin publik-9. Kriteret e dhënies së kontratës;

Të nderuar ne me daten 20.11.2023 permes platformes elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-se në vlerësimin e fazës së pare të projekteve në këtë procedure
Ne pas kërkesës për qasje në dokumentacionin e e ku na është lejuar qasja, kemi vërejtur se duke u bazuar ne dokumentet qe kemi pasur qasje ne kemi pare qe projekti i shifres 2000 cili eshte vleresuar me 71.58%, eshte projekt i cili eshte kopje e projekteve te meparshme te kesaj lemie qe jane zhvilluar me heret, ndersa projekti yne si nje projekt unik dhe i punuar enkas per kete procedure eshte vlereusar me 60.14% andaj si te tille anetaret e jurise eshte dashur qe shifren ne fjale te eliminojne nga procedura dhe jo te poentohet me pike.
-Projekti ynë është një projekt i cili ka përmbushur të gjitha kriteret ne dosjen e tenderet, si dhe zgjedhja që ne kemi ofruar është një zgjedhje e cila ka për qëllim: më së miri përdoriminin efikas të hapësirave ekzistuese dhe për adekuate për mjedisin për rreth, programi i cili është më ekonomik për Komunën, ofrimin e zhvillimit të

komunikacionit dhe mjaft kreativ në krahasim me ofertat që janë vlerësuar me pikët maksimale, pasi që projektet më lartë janë projekte të cilat gjatë implementimit nuk do te arrijnë qëllimet të cilat ju i keni kërkuar dhe janë projekte të cilat do jetë edhe problem për t'u ekzekutuar në të ardhmen.

Ne do ju bashkangjisim edhe projektin e cila eshte ndertuar ne lokacione si komuna e Prizrenit, Komuna e Fushe Kosoves dhe Graqanices po i njejti projekt siq e ka prezantuar edhe shifra ne fjale. Ndersa procedurat e Konkurseve te Projektimit jane procedura ku duhet te konkurohet per projekte unike dhe jo me te njejtin projekt.

Gjithashtu ne si Operator ekonomik ne qasjen e dokumenteve kemi pare qe rivleresimi i projekteve eshte bere nga e njejta juri sikurse ne vleresimin e pare, anaj kjo eshte e kunderligjshme si dhe si eshte e mundur qe po e njejta juri te beje dy vleresime te projektit te njejte me pike te ndryshme, perveq se eshte e kunderligjshme vleresimi i njejtes juri shihet edhe tendenca qe kane bere dhe te deklarates nenbetim per proceduren e tenderit.

1

Vlerësimi i projektit idor nga Juria konform neni 80 te LPP rezultati i Jurisë: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë" Numri i aktivitetit te prokurimit: 328-23-6142-2-2-3, Ne i brendshëm: 33300/923/917223

Nr.	Kodi i Operatorit Ekonomik	Piket e projektit
1.	7890	23.3%
2.	2000	16.5%
3	7878	13.9%
4	1618	11.9%
5	1183	8.9%

Data:09.08.2023

Anetaret e Jurisë

1. Prof. Asoc. Dr. – Arkitektura M.D.

2. Ass.Dr.-Arkitektura- B.K.B

3. Inxh.i Dip. i Makinerisë—A.Z

Besim Uka-dorëshkruar
Shef i njësisë prokurimit

2

RI -Vlerësimi i projektit idor nga Juria konform neni 80 te LPP rezultati i Jurisë: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë" Numri i aktivitetit te prokurimit: 328-23-6142-2-2-3, Ne i brendshëm: 33300/923/917223

Nr.	Kodi i Operatorit Ekonomik	Piket e projektit
1.	Oferta 2000	71.58
2.	Oferta 1183	64.04
3	Oferta 7878	60.14
4	Oferta 7890	59.9
5	Oferta 1616	54.62

Data: 28.11.2023

Anetaret e Jurisë

1. Prof. Asoc. Dr. – Arkitektura M.D.

2. Ass.Dr.-Arkitektura- B.K.B.

3. Inxh.i Dip. i Makinerisë—A.Z

Besim Uka-dorë

Ne ne qasje kemi kerkuar qe te na ofrohet edhe vleresimi sipas nenkritereve ne dosjen e tenderit,
Mirepo ky vleresim na eshte mohuar nga zyrtari i prokurimit.
Ai eshte shprehur qe vleresimi i pikeve mund te kene vetem prokuroria dhe OSHP.

Kerkojme nga ana juaj qe lenda te kthehet ne rivleresim, qe te vleresohen projektet drejt nga nje komision i pavarur, si dhe jo i njejti siq keni vepruar ju, dhe te shqyrtohen projektet ne menyre te drejte pasi qe nga vleresimi ne e kemi te pa qarte se procedura eshte zhvilluar per te favorizuar shifra 2000, pasi qe e njejta kompani ka projektuar edhe projektet e objektet e gjykatave tjera siq jeni ne njohuri ju ndersa shifra e kompanise sone eshte me pike me pak ku ideja, koncepti ka qene unik dhe i pa ndertuar, dhe i patenderuar. Gjithashtu ne fazen te cilen ne deri me tani jemi shihet qartas se projektet i prezantuar eshte i Advanced Group Of Architecture SH.P.K., si dhe te gjitha projektet e kompanive tjera jane zbuluar qe kujt i perkasin, dhe si procedure duhet te shiqohet te ritenderohet,

-Gjithashtu AK-ja nuk e ka plotësuar edhe nenin 7-të LPP-së, ku edhe pse jemi OE i përgjegjshëm dhe gjithashtu kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-se dhe njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7-të LPP-së e parasheh qartas qe Autoriteti Kontraktues do ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, Poashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së një aktivieti të prokurimit të gjitha autoritet kontraktuese do të sigurojnë që (vi)që tenderi i zgjedhur të pëeputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse mirepo AK-ja nu ki është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet edhe qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikasë, më transparente dhe më të drejtë të shfrytezimit të fondeve publike, burimeve publike dhe të gjitha fondeve dhe burimevë të tjera të autorieteve kontraktuese në Kosovë, pasi që projekti i cili është vlerësuar është një projekt i cili do të jetë i kushtueshëm dhe i pa realizueshëm.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga ana juaj si OSHP që të merr:

VENDIM

Aprovohet, si e bazuar Anksesa e kompanisë sonë
Anulohet, njoftimi mbi vendimin e AK-së për vleresimin e fazes se pare te projekti
de lenda të kthehet në Rivlerësim, dhe gjatë rivleresimit, ekzaminimit, vleresimit dhe krahasimit të ofertave të bëhet siq e parashikon ligji nga profesionist të kësaj lëmie dhe rivlerësimi të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professiona	**Dësmia e kërkuar dokumentare**
Operatori ekonomik ofertuesi që ofertoni duhet te posedoië inxhinier me përvoje së paku pese (5) viecare ne drejtimet: 1. Së paku një (1) Inxhinier Ndërtimtarisë I Diplomuar ose Një Bachelor me Master i Ndërtimtarisë; 2. Së paku një (1) Inxhinier i Arkitekturës i Diplomuar Ose Një Bachelor me Master i Arkitektures; 3. Së paku një (1) Inxhinier i makinerisë i diplomuar Ose Një Bachelor me Master i Makinerisë; 4. Së paku një (1) Inxhinier i Elektroteknikes i Diplomuar Ose Një Bachelor me Master i Elektroteknikes; 5. Së paku një (1) Inxhinier i Gjeodezisë i diplomuar Ose Një Bachelor me Master i Gjeodezisë. Dësmia e kërkuar dokumentare	1.Diplomat e Inxhinierëve duhet te jene te (Noterizuara data e Noterizimit nuk duhet te ietë më shume se Nëntëdhietë (90) dite kalendarike nga data e publikimit këtij aktiviteti - Njoftimit për Kontratë). 2.Te prezantohen CV-it, përvoja e punës për secilin Vec e Vec; 3. Te prezantohen kontratat e punës, Ose para kontrata - marrëveshje në emër të projektit me ofertuesin - operatoren ekonomik si dhe te jen të (Noterizuara data e Noterizimit nuk duhet te ietë më shume se Nëntëdhietë (90) dite kalendarike nga data e publikimit këtij aktiviteti Njoftimit për Kontratë).
Operatori ekonomik Ofertuesi duhet të ofroi dëshmi se ka kontratë apo kontrata të përfunduara te projekteve ndërtimore dhe te mbikëqyrjes se punimeve ndërtimore ne tri (3) vitet e shkuara nga Data e Publikimit të Njoftimit për Kontratë. vlera e përgjithshme monetare e tyre duhet te jetë jo më e vogël se 80,000.00 €.	Lista e kontratave te realizuara se bashku me Referenca ose Raporte te Pranimit.
Ofertuesi – Operatori ekonomik Kompania Projektuese në ofertë duhet të paraqes (planin dinamik) afatin e dorëzimit Punimi i projektit kryesor për objektin e Gjykatës Themelore Pejë.	Deklaratë të Nënshkruar edhe e Vulosur ku Ofertuesi Kompania Projektuese deklaron se kohëzgjatja e dorëzimit e projektit kryesor te kompletuar sic është kërkuar ne D.T., specifikat teknike ANKESI 1. Punimi i projektit kryesor për objektin e Gjykatës Themelore Pejë dorëzohet ne dite kalendarike nga urdhëresa e menaxheri te kontratës nga Autoritetit Kontraktues.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR I KOSOVËS
SEKRETARIJAT SUDSKOG SAVETA KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL SECRETARIAT
Nr.Br.No. 05 / 1818
24. 11. 2023
PRISHTINË - A

SEKRETARIATI – SEKRETARIJAT - SECRETARAIT

Datë: 24.11.2023
Nr.Ref./ZP/179/2023

Bazuar Ligjit Prokurimit Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 108/A pika 2, dhe Rregullave për parashtrimin e ankesave te miratuara nga KRPP, për Prokurim Publik, sipas Kërkesës për Rishqyrtim nga Operatori Ekonomik me Shifrën – Kodin e dorëzimit te ofertës – projektit ***7878***, për aktivitetin e prokurimit me titull: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, ri vlerësim, me numër te prokurimit: 328-23-6142-2-2-3, dhe numër te brendshëm: 33300/023/017/223.

V E N D I M
MBI REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM SI TË PABAZUAR

I.*Refuzohet ne Tërësi kërkesa për Rishqyrtim* për Operatori Ekonomik me Shifrën – Kodin e dorëzimit te ofertës – projektit 7878, për aktivitetin e prokurimit me titull: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, ri vlerësim, me numër te prokurimit: 328-23-6142-2-2-3, dhe numër te brendshëm: 33300/023/017/223.

II. ***Vërtetohet*** vendimi i jurisë i datës **20/11/2023** bazuar nenit 80 LPP-se dhe Rr.Nr.00/2022 për P.P, neni 55, për aktivitetin e prokurimit me titull: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, ri vlerësim me numër te prokurimit: 328-23-6142-2-2-3, dhe numër te brendshëm: 33300/023/017/223.

III. ***Autorizohet*** Autoriteti Kontraktues: Sekretariati Këshilli Gjyqësor të Kosovës, te respektoj Vendimin e jurisë për procedurat e prokurimit sipas LLP-se, nenit 80 dhe RR.nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

IV. ***Obligohet*** Autoriteti Kontraktues: Sekretariati Këshilli Gjyqësor të Kosovës, qe kërkesën për ri shqyrtim është Pa Bazuar të ja komunikoj parashtruesit te ankesës dhe te gjitha palëve te interesuar.

V. ***Vendimi*** i jurisë për Autoritetin Kontraktues: Sekretariati Këshilli Gjyqësor të Kosovës, është i detyrueshëm. Dosja e tenderit: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, i publikuar me date ***15.06.2023***, Tek **Pjesa II.Fleta e të dhënave të tenderit (FTD), Udhëzimet e tenderuesit; Përshkrimi i nenit : Vendimi i Jurisë; Neni 5.1 Vendimi i Jurisë është detyrues për autoritetin kontraktues: Po ☒ shiko Faqe 9.**

VI. ***Vendimi*** hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues: Sekretariati Këshilli Gjyqësor të Kosovës, ka zbatuar vendimin e panelit shqyrtues me numër OSHP:2023/0607, pikën II lënda: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, me numër te prokurimit: 328-23-6142-2-2-3, dhe numër te brendshëm: 33300/023/017/223, është kthyer ne ri vlerësim komfor pretendimeve ankimore te nxjerr ne vendim nga paneli shqyrtues i OSHP-se.

1. Pretendimi i juaj se ri vlerësimi i projekteve është bere nga e njëjta juri.

1.1 Përgjigje e pretendimit ju lutem operator ekonomik na gjeni ne legjislacionin qe është ne fuqi ne Republikën e Kosovës Ligjit nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 , dhe Rregulloren .nr.001/2022 Për Prokurim Publik, ne cilin nene ose paragraf ceket decidivisht qe **JURIA** ne përbërje te njëjtë nuk mundet te bej ri vlerësimim e ofertave - Projekteve.

2. Pretendimi i juaj ne qasje kemi kërkuar qe te na ofrohet edhe vlerësimin e jurisë sipas nen kritereve ne dosjen e tenderit mirëpo ky vlerësim na është mohuar nga zyrtari i prokurimit, ai është shprehur qe vlerësimi i pikëve mund te kenë vetëm prokuroria dhe OSHP.

2.1 Përgjigje e pretendimit Autoriteti Kontraktues: Sekretariati Këshilli Gjyqësor të Kosovës, departamenti i prokurimit ju ka ofruar qasje te **PA LIMITUAR** ne komplet **ne tri (3)** projektet ideore te cilat i keni pranuar ne **USB**; Gjithashtu keni pranuar Vendimin e Jurisë te nxjerr me date 20.11.2023. Pikët e nen kritereve janë te përcaktuar me Ligjit nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Neni 80 Përbërja dhe Vendimet e Jurisë pika 5. Personave që nuk janë anëtarë të jurisë do t'u zbulohet vetëm vendimi i jurisë. Diskutimet e jurisë dhe opinionet e anëtarëve të jurisë gjatë diskutimeve të tilla do të mbahen si sekret nga të gjithë anëtarët e jurisë. Asnjëri nga anëtarët e jurisë nuk do të zbulojë përmbajtjen e diskutimeve të jurisë para një personi tjetër që nuk është anëtar i jurisë, përveç kur kërkohet nga një urdhër me shkrim nga KRPP-ja, OSHP, ose një gjykatë kompetente.

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij vendimi: Operatori Ekonomik: Shifrën – Kodi i ofertës – projektit 7878; Mund të paraqet ankesë për zgjedhjen ne mosmarrëveshjes pranë Organit Shqyrtues Prokurimit, (OSHP-së), konfom me afatin ligjor ne afat prej dhjet (10) nga data e ngarkimit te këtij Vendimi ne platforme E-Prokurim, dita e parë zero (O).

Prishtinë
24/11/2023

Besar Maqedonci
Drejtori i Departamentit prokurimit
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor te Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- Operatori Ekonomik: Shifrën – Kodi i ofertës – projektit **7878,** (Ngarkohet ne Platformën E –Prokurim);
- Te gjithë Operatoreve Ekonomik tjerë pjesëmarrës ne ketë aktivitet (Ngarkohet ne Platformën E –Prokurim);
- Zyrës Prokurimit;
- Arkivit SKGJK-se.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **ARHIKO .ING SH.P.K.**

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së kundër vendimit të AK-së, duke ngritur disa pretendime, ku sipas tyre AK ka bërë dis shkelje gjatë procedurave të vlerësimit. Përgjigjet në pretendimet e ngritura janë si më poshtë. Pretendimet e mëposhtme të cilat kanë të bëjnë me aspektin teknik, për të njëjtat është përgjigjur eksperti teknik.

Pretendimi Ankimor 1:

Sipas pretendimit ankimor 1 operatori ekonomik ankues ka shfaqur vërejtjet si më poshte për të cilat eksperti edhe ka bërë vleresimin e fakteve dhe sqaron se:

Pretendimet e ankuesit

Të nderuar ne me daten 20.11.2023 permes platformes elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-se në vlerësimin e fazës së pare të projekteve në këtë procedure

Ne pas kërkesës për qasje në dokumentacionin e e ku na është lejuar qasja, kemi vërejtur se duke u bazuar ne dokumentet qe kemi pasur qasje ne kemi pare qe projekti i shifres 2000 cili eshte vleresuar me 71.58%, eshte projekt i cili eshte kopje e projekteve te meparshme te kesaj lemie qe jane zhvilluar me heret, ndersa projekti yne si nje projekt unik dhe i punuar enkas per kete procedure eshte vlereusar me 60.14% andaj si te tille anetaret e jurise eshte dashur qe shifren ne fjale te eliminojne nga procedura dhe jo te poentohet me pike.

-Projekti ynë është një projekt i cili ka përmbushur të gjitha kriteret ne dosjen e tenderet, si dhe zgjedhja që ne kemi ofruar është një zgjedhje e cila ka për qëllim: më së miri përdoriminin efikas të hapësirave ekzistuese dhe për adekuate për mjedisin për rreth, programi i cili është më ekonomik për Komunën, ofrimin e zhvillimit të komunikacionit dhe mjaft kreativ në krahasim me ofertat që janë vlerësuar me pikët maksimale, pasi që projektet më lartë janë projekte të cilat gjatë implementimit nuk do te arrijnë qëllimet të cilat ju i keni kërkuar dhe janë projekte të cilat do jetë edhe problem për t'u ekzekutuar në të ardhmen.

Ne do ju bashkangjisim edhe projektin e cila eshte ndertuar ne lokacione si komuna e Prizrenit, Komuna e Fushe Kosoves dhe Graqanices po i njejti projekt siq e ka prezantuar edhe shifra ne fjale. Ndersa procedurat e Konkurseve te Projektimit jane procedura ku duhet te konkurohet per projekte unike dhe jo me te njëjtin projekt. Gjithashtu ne si Operator ekonomik

ne qasjen e dokumenteve kemi pare qe rivleresimi i projekteve eshte bere nga e njejta juri sikurse ne vleresimin e pare, anaj kjo eshte e kunderligjshme si dhe si eshte e mundur qe po e njejta juri te beje dy vleresime te projektit te njejte me pike te ndryshme, perveq se eshte e kundërligjshme vleresimi i njejtes juri shihet edhe tendenca qe kane bere dhe te deklarates nenbetim per proceduren e tenderit

Ne ne qasje kemi kerkuar qe te na ofrohet edhe vleresimi sipas nenkritereve ne dosjen e tenderit, Mirepo ky vleresim na eshte mohuar nga zyrtari i prokurimit. Ai eshte shprehur qe vleresimi i pikeve mund te kene vetem prokuroria dhe OSHP. Kerkojme nga ana juaj qe lenda te kthehet ne rivleresim, qe te vleresohen projektet drejt nga nje komision i pavarur, si dhe jo i njejti siq keni vepruar ju, dhe te shqyrtohen projektet ne menyre te drejte pasi qe nga vleresimi ne e kemi te pa qarte se procedura eshte zhvilluar per te favorizuar shifra 2000, pasi qe e njejta kompani ka projektuar edhe projektet e objektet e gjykatave tjera siq jeni ne njohuri ju ndersa shifra e kompanise sone eshte me pike me pak ku ideja, koncepti ka qene unik dhe i pa ndertuar, dhe i patenderuar. Gjithashtu ne fazen te cilen ne deri me tani jemi shihet qartas se projektet i prezantuar eshte i Advanced Group Of Architecture SH.P.K., si dhe te gjitha projektet e kompanive tjera jane zbuluar qe kujt i perkasin, dhe si procedure duhet te shiqohet te ritenderohet, -Gjithashtu AK-ja nuk e ka plotësuar edhe nenin 7-të LPP-së, ku edhe pse jemi OE i përgjegjshëm dhe gjithashtu kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-se dhe njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7-të LPP-së e parasheh qartas qe Autoriteti Kontraktues do ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, Poashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së një aktivieti të prokurimit të gjitha autoritet kontraktuese do të sigurojnë që (vi)që tenderi i zgjedhur të pëeputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse mirepo AK-ja nu ki është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet edhe qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikasë, më transparente dhe më të drejtë të shfrytezimit të fondeve publike, burimeve publike dhe të gjitha fondeve dhe burimevë të tjera të autorieteve kontraktuese në Kosovë, pasi që projekti i cili është vlerësuar është një projekt i cili do të jetë i kushtueshëm dhe i pa realizueshëm.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues- "Arhiko ING"

<u>Pretendimi 1.1</u>

Ne pas kërkesës për qasje në dokumentacionin e ku na është lejuar qasja, kemi vërejtur se duke u bazuar ne dokumentet qe kemi pasur qasje ne kemi pare qe projekti i shifres 2000 cili është vlerësuar me 71.58%, është projekt i cili është kopje e projekteve te mëparshme te kesaj lemie qe jane zhvilluar me heret, ndersa projekti yne si nje projekt unik dhe i punuar enkas per kete procedure eshte vlereusar me 60.14% andaj si te tille anetaret e jurise eshte dashur qe shifren ne fjale te eliminojne nga procedura dhe jo te poentohet me pike.

Ne do ju bashkangjisim edhe projektin e cila eshte ndertuar ne lokacione si komuna e Prizrenit, Komuna e Fushe Kosoves dhe Graqanices po i njejti projekt siq e ka prezantuar edhe

shifra ne fjale. Ndersa procedurat e Konkurseve te Projektimit jane procedura ku duhet te konkurohet per projekte unike dhe jo me te njejtin projekt.

Pergjigje e ekspertit ne pretendimin 1.1

Sipas ekspertit teknik këto pretendime të ngritura janë të bazuara dhe të argumentuara edhe me dëshmi. Mirëpo lidhur me këtë pretendim duhet të shtojmë se;

Çështja e vlerësimit apo poentimit për projektin ideor është përgjegjësi e AK, përmes jurisë profesionale në pajim më kriteter e detyrës projektuese. Ndërsa në anën tjetër pjesmarrët në procedurën tenderuese duhet që projektin ideor të përgatisin dhe të dorëzojnë sipas kritereve të detyrës projektuese.

Ajo që vlen të theksohet është së çështja e projektimeve është e rregulluar me LPP dhe me rregulloren Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik. Neni 4.1.16 i LPP përcakton se **Konkurs projektimi** - një procedurë prokurimi që ka për qëllim t'i mundësoj autoritetit kontraktues të fitoj një plan ose një projekt të zgjedhur nga një juri, pasi që është vënë në konkurrim me ose pa shpërblim, veçanërisht në sferat e planifikimit hapësinor, planifikimit urbanistik, arkitekturës, ingjinieringut, përpunimit të të dhënave, dhe projektet e veprave të artit.

Faktet e paraqitura nga OE ankues në lidhje me projektin ideor të OE fitues janë fakte të reja të cilat Juria profesionale në kohen e vlerësimit të tenderit në lidhje me këtë fakt nuk ka pasur informata. Ndërsa sipas pretendimeve të OE ankues vërejmë se projekti ideor i OE fitues, sa i përkët arkitekturës së jashtme është identike me Gjykatën Themelore në Prizren. Gjatë vlerësimit të projektit AK këto fakte të reja duhet ti merren parasysh dhe OE me projekt identik duhet te penalizohet, pasi qellimi i konkurseve te projektimit eshte të fitohet një objekt origjinal, përndryshe KGJK mund të perdorë vetem një konkurs projektimi, dhe atë të përdorte si projekt model për projektet e ardhshme me modifikimet e nevojshme varesisht nga kerkesat specifike dhe situacioni i terrenit. Eksperti teknik konsideron se pretendimi është i bazuar.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 1.1 , konsideron se pretendimi eshte i bazuar.

Pretendimi 1.2

-Projekti ynë është një projekt i cili ka përmbushur të gjitha kriteret ne dosjen e tenderet, si dhe zgjedhja që ne kemi ofruar është një zgjedhje e cila ka për qëllim: më së miri përdoriminin efikas të hapësirave ekzistuese dhe për adekuate për mjedisin për rreth, programi i cili është më ekonomik për Komunën, ofrimin e zhvillimit të komunikacionit dhe mjaft kreativ në

krahasim me ofertat që janë vlerësuar me pikët maksimale, pasi që projektet më lartë janë projekte të cilat gjatë implementimit nuk do te arrijnë qëllimet të cilat ju i keni kërkuar dhe janë projekte të cilat do jetë edhe problem për t'u ekzekutuar në të ardhmen.

Pergjigje e ekspertit ne pretendimin 1.2

Sipas ekspertit teknik ky pretendim është subjektiv dhe pa ndonjë argument specifik, dhe nuk është i bazuar sepse OE ankues nga vlerësimi i jurisë profesionale është vlerësuar me pikë prej 60.14%.

Pretendimi 1.3

Si Operator ekonomik ne qasjen e dokumenteve kemi pare qe rivleresimi i projekteve eshte bere nga e njejta juri sikurse ne vleresimin e pare, anaj kjo eshte e kunderligjshme si dhe si eshte e mundur qe po e njejta juri te beje dy vleresime te projektit te njejte me pike te ndryshme, perveq se eshte e kunderligjshme vleresimi i njejtes juri shihet edhe tendenca qe kane bere dhe te deklarates nenbetim per proceduren e tenderit.

Pergjigje e ekspertit ne pretendimin 1.3

Sipas ekspertit shqyrtues, dispozita e Rregullores në të cilën është thirrur OE ankues ka të bëjë me rastin kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk e pranon rekomandimin e komisionit të vlerësimit, atëherë ai mund të formoj komision të ri për rivlerësim apo mund të nxjerr vendim përfundimtar ashtu siç e thotë edhe rregullorja. Mirëpo, në rastin kur lënda kthehet në rivlerësim me vendim të OSHP-së në asnjë dispozitë ligjore nuk përmendet fakti se AK duhet të formoj komision të ri të rivlerësimit sapo lënda të kthehet në rivlerësim me vendim nga OSHP. Andaj, vlerësojmë se ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi 1.4

Në qasje kemi kërkuar qe te na ofrohet edhe vleresimi sipas nenkritereve ne dosjen e tenderit, mirepo ky vleresim na eshte mohuar nga zyrtari i prokurimit. Ai është shprehur qe vleresimi i pikeve mund te kene vetem prokuroria dhe OSHP.

Pergjigje e ekspertit ne pretendimin 1.4

Sipas ekspertit shqyrtues, neni 80 i Ligjit për Prokurimin Publik thotë se: "Personave që nuk janë anëtarë të jurisë do t'u zbulohet vetëm vendimi i jurisë. Diskutimet e jurisë dhe opinionet e anëtarëve të jurisë gjatë diskutimeve të tilla do të mbahen si sekret nga të gjithë anëtarët e jurisë. Asnjëri nga anëtarët e jurisë nuk do të zbulojë përmbajtjen e diskutimeve të jurisë para një personi tjetër që nuk është anëtar i jurisë, përveç kur kërkohet nga një urdhër me shkrim nga KRPP-ja, OSHP, ose një gjykatë kompetente."

Sipas këtij neni të LPP-së, mendimi i ekspertit shqyrtues është se OE ankues mund të ketë qasje vetëm në vendimin e jurisë, por jo edhe në vlerësimin sipas nënkritereve. Andaj ky pretendim vlerësojmë se është i pabazuar.

Mendimi i Ekspertit Teknik

Nga analizimi dhe vlerësimi i procesit të aktivitetit të prokurimit ka pasur disa mangësi të cilat mund të kenë ndikuar në vlerësim objektiv të projektit.

Ky aktivitet i prokurimit fillimisht është përcjellur me ankes në OSHP, dhe kemi vërejtur se me rastin e ankesës është zbuluar identiteti i pjesëmarrësve në këtë proces. Autoriteti Kontraktues nuk është siguruar që identiteti i OE-ve të mos zbulohet duke ju ndryshuar kodet para prezantimit para jurisë profesionale. Pra në këtë proces nuk është zbatura parimi i anonimitetit te pjesëmarrësve në proces, pasi që juria profesionale për disa OE vetëm se i kishte të njohur identitetin e tyre. Zbulimi i identitetit të operatorit ekonomik është në kundërshtim me neni 80 paragrafi 3 të LPP-së I cili saktëson se "Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kritereve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë. Andaj ky pretendim është i bazuar.

Sipas Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik, neni 55 Konkurs për Projektim, kërkohet që procesi i konkursit për projektim të identiteti i pjesëmarrësve nuk do t'i shpaloset jurisë, zyrtari përgjegjës i prokurimit do t'i hap zarfet e pranuara dhe do t'i ndajë zarfet që përmbajnë "projektet ideore" tutje, Dosja e konkursit të projektimit. Dërgesa e dosjes së konkursit për *projektim 55.14 Zarfi që përmban projektin Ideor do të përmbajë: a. ekzemplarin origjinal të projektit; dhe b. numrin kopjet e projektit siç është specifikuar në Dosjen e konkursit të projektimit Pjesëmarrësi do ta mbyllë projektin origjinal dhe secilën kopje në zarfe të veçanta dhe në faqen e përparmë të secilit zarf do të: a. Shënojë qartë si "Origjinali – Projekti Ideor" ose "Kopje – Projekti Ideor"; b. Shënoj numrin e Prokurimit sikurse ceket në dosjen e konkursit të projektimit; dhe c.* ***Një numër anonim prej katër shifrave sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit.***

Në këtë aktivitet të prokurimit AK ka përdorur konkurs projektimi duke përfshirë edhe shërbimet e mbikqyrjes së realizimit të projektit. Kjo vërehet tek FDT, pika 28.2 shërbimi i projekteve, ku oferta financiare për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit peshohet me 20%. Bazuar në Rregulloren për Prokurim Publik 001/2022 janë përcaktuar kushtet ne lidhje me përdorimin e konkursit te projektimit: Përdorimi i konkursit për projektim

.....

55.7 ***Procedura nuk mund të përdoret për furnizimin e shërbimeve (përveç planit ose vet projektimit). Aty ku kërkohen punimet apo shërbimet me qëllim që të zbatohet plani apo projektimi, atëherë kontrata për ekzekutimin e shërbimeve apo punimeve duhet të jepet veçmas.***

Si përfundim, nga rivlerësimi i aktivitetit të prokurimit OE i renditur me pikët më të lartë rezulton të ketë prezantuar një projekt idor i cili nuk paraqet një projekt të ri të dizajnuar apo me ndonjë inovacion specifik, por është një projekt pothuaje ekzistues i cili është përdorur si projekt ideor apo edhe final për disa projekte të ngjashme të zhvilluara nga AK i njëjtë.

Në bazë të gjetjeve të identifikuara në këtë aktivitet të prokurimit konsideroj së ky aktivitet është përcjellur me disa mangësi, dhe duke marrë për bazë që ky projekt është i një rëndësie të lartë dhe ka një kosto të konsiderueshme do të duhej ti jepej një kujdes i shtuar gjatë vlerësimit të projekteve ideore.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik/shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht i bazuar dhe rekomandon që të anuloj në tërësi këtë aktivitet të prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ARHIKO .ING SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Agnese Ibrahimi

Taulant Ahmeti